REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE

| Dërguar më / Dostavljeno | 25.07.2025 | |
|---|---|---|
| Njësi.org. / Org. jed. | Nr. / Br. | Shtojcë - Prilog |
| 02-463/ | 06-0043417/25 | |

PODUJEVË - PODUJEVO

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 4 dhe 10 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139 dhe ndryshim plotësimet me Ligjin nr. 03/L-205, nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 dhe neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës Nr.Prot. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me Hartën Zonale të Komunës së Podujevës (HZK) për periudhën 2022-2030 , e miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. Prot. 01-020/02-0030654/22, datë 29 prill 2022 dhe Vendimin për shpallje në interes të përgjithshëm publik nr.prot.01-463/06-0033716/2 datë 23 maj 2024 si dhe me kërkesën Nr. Prot. 02-464/01-0022232/24 datë 05 prill 2024 të Drejtorisë së Arsimit , merr këtë:

## VENDIM PRELIMINAR

**Neni 1**

Miratohet kërkesa e subjektit kërkues Drejtoria e Arsimit -Komuna e Podujevës, për shpronësimin e disa objekteve në Zonën Kadastrale Podujevë, sipas Listës me përshkrim detaj të paluajtshmërive, si në shtojcë të këtij Vendimi, për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik, realizimin e projektit ***"Ndërtimi i Çerdhes''***

**Neni 2**

Obligohet Drejtoria e Arsimit në cilësinë e subjektit kërkues që në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Pronës , Kadastrit dhe Gjeodezisë brenda pesë (5) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi t'i njoftojë pronarët ose zotëruesit të interesit në pjesë të pronave të paluajtshme të cilat preken me realizimin e projektit dhe brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, i njëjti shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Neni 3**

Kundër këtij vendimi apo cilësdo pjesë të tij, secili do person i cili është pronarë dhe zotërues i interesit në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim, ka të drejtë të paraqes ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Themelore në Prishtinë –Dega në Podujevë.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Arsimit , Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave si dhe Drejtoritë dhe shërbimet tjera varësisht nevojave të paraqitura në funksion të realizimit të këtij projekti.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në ueb faqen e Komunës dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

*Vendimi u dërgohet:*
- *Të gjitha Drejtorive të Komunës*
- *Qendrës së Shërbimit për Qytetarë*

**Nr. Prot.** 02-463/06-0043417/25
**Podujevë, datë:** 25.07.2025

Kryetari i Komunës
Shpëtim Bulliqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO

| Ndertesa | Nr | Emri mbiemri i pronarit ose zotëruesit | Nr.i pjesës së ndërtesës | Lloji i shfrytëzimit | Zona Kadastrale | Sipërfaqja e përgjithshme $m^2$ | Sipërfaqja e pjesës së ngastrës për shpronësim $m^2$ |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Bashkëpronësi në Ndërtesë Në pjesët e përbashkëta<br>2153-1-121-0<br>Siperfaqja e bazamentit 749 $m^2$ | 1 | Fatmir ( Hysen ) Stublla (qirambajtje 99 vite ) | 2153-1-121-1-7-0 | Lokal | Podujevë | 114 | 114 |
| | 2 | Blerim ( Avdyl ) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga ½ (qirambajtje 99 vite ) | 2153-1-121-1-6-0 | Lokal | Podujevë | 344.1 | 344.1 |
| | 3 | Fatmir ( Hysen ) Stublla (qirambajtje 99 vite ) | 2153-1-121-1-5-0 | Objekte te tjera | Podujevë | 6 | 6 |
| | 4 | Blerim ( Avdyl ) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga ½ (qirambajtje 99 vite ) | 2153-1-121-1-4-0 | Lokal | Podujevë | 134.86 | 134.86 |
| | 5 | -Blerim ( Avdyl ) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga ½ (qirambajtje 99 vite) | 2153-1-121-1-3-0 | Lokal | Podujevë | 45.08 | 45.08 |
| | 6 | Blerim ( Avdyl ) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga ½ (qirambajtje 99 vite ) | 2153-1-121-1-2-0 | Lokal | Podujevë | 241.8 | 241.8 |
| | 7 | Blerim ( Avdyl ) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga ½ (qirambajtje 99 vite ) | 2153-1-121-1-1-0 | Lokal | Podujevë | 110.05 | 110.05 |

**Drejtori i Drejtorisë së Arsimit**

**Avni Fetahu**______

**Drejtoreshë e DPKGJ-së**

**Saranda Stublla**______

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO
PODUJEVË